

**VENDIM**  
**I GJYQARIT TË VETËM**

Sot, më datë 14 . 12 . 2001, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, **Majlinda Dogga** pasi studiova kërkesën e paraqitur nga kërkuësja Znj. Klotilda Ferhati në cilësinë e përfaqësueses ligjore të Shoqërisë "ALMOD" Sh.p.k., në bazë të prokurës lëshuar në emër të saj nga Administratori i Shoqërisë Z. Isuf Isufi, për depozitimin në Regjistrin Tregtar të Vendimit të Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të Shoqërisë "ALMOD" Sh.p.k., datë 02.10.2001, më poshtë referuar si "Shoqëria",

**KONSTATOVA:**

Me vendim Nr. 7802, datë 29.12.1994, marrë nga Gjykata e Rrethit Tiranë, është regjistruar në Regjistrin Tregtar të kësaj gjykate Shoqëria "Almod" sh.p.k.

Më datë 02.10.2001, në orën 10:30, në Tiranë, në selinë e Studio Legale Tonucci International Laeyers Sh.p.k. me pjesmarrjen e Z. Paolo Gennari si përfaqësues i autorizuar i ortakut Simod dhe Znj. Valentina Pine si përfaqësuese e ortakut shtetëror, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, si dhe të të ftuarve Z. Nicola di Giovanni, Znj. Klotilda Ferhati dhe Z. Isuf Isufi, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme e shoqërisë Almod me këtë rend dite:

1. diskutimi i raportit mbi gjendjen e Shoqërisë dhe mbi masat e duhura për të kapërcyer gjendjen që është krijuar;
2. Miratimi i bilancit të vitit 2000;
3. Privatizimi ose likuidimi i mundshëm i Shoqërisë;
4. Të ndryshme.

Pas një diskutimi të detajuar, duke u nisur nga gjendja e vështirë ekonomike e Shoqërisë dhe nga mungesa e dokumentacionit të saktë financiar, bilanceve përpara vitit 2000, mungesë kjo që shkakton paqartësi në kuptimin e gjendjes aktuale të Shoqërisë, Asambleja me unanimitet ka vendosur:

1. t'i japë Kryetarit dhe financierëve përgjegjës të Shoqërisë një periudhë kohe jo më shumë se 1 (një) muaj, duke filluar nga data 02.10.2001, për të gjetur bilancet dhe dokumente të tjera kontabël të Shoqërisë për periudhën duke përfshirë fillimin e aktivitetit dhe deri 31.12.1999, duke iu referuar veçanërisht faturave dhe dokumenteve të tjera kontabël vërtetues, raporteve midis Shoqërisë dhe Simod, e cila do të përballojë shpenzimet e nevojshme për këtë aktivitet;
2. të mos diskutojë pikën nr. 2) të rendit të ditës;

3. mbi pikën 3), të mos proçedojë për momentin në likuidimin ose privatizimin e Shoqërisë, por të vlerësojë propozimin e nënshkrimit të një kontrate të mundshme qiraje të fabrikës me persona të tjerë të interesuar, që mund të nënshkruhet menjëherë sapo aktiviteti për të cilën flitet në pikën 1) do të përfundohet në mënyrë të kënaqshme për të dy ortakët.

Pas kësaj, ortakët kanë bërë të ditur se Kryetari i Asamblesë, Z. Isufi, i cili muajt e fundit ka vepruar si administrator i Shoqërisë, nuk ka qenë emëruar kurrë në një pozicion të tillë, dhe me marrëveshje të përbashkët i kanë propozuar Kryetarit, Z. Isufi, të marrë përsipër detyrën e administratorit të vetëm të Shoqërisë dhe Z. Isufi ka pranuar.

Kryetari ka bërë të ditur gjithashtu se prej disa kohësh nuk ka më lajme për ekspertët kontabël të emëruar nga asambleja e datës 10.4.1995, dhe që ata nuk janë zëvendësuar kurrë: prandaj i propozoi asamblesë shkarkimin dhe zëvendësimin e tyre. Ortakët deklaruan se janë dakort dhe në veçanti Ministria mori përsipër të lajmërojë një person që të jetë në gjendje për të kryer detyrën e ekspertit kontabël të shoqërisë, i cili do të emërohet si i tillë në mbledhjen vijuese të Asamblesë.

Si përfundim, ortaku Simod bëri të ditur se, në bazë të ligjit nr. 7926 datë 20.4.1995 *Mbi transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare*, si dhe në bazë të ligjit nr. 8237 datë 1.9.1997, Ministria ka marrë përsipër cilësinë e ortakut të Shoqërisë, duke ndërhyrë në Fabrikën e Këpucëve të Gomës nr. 2 të Durrësit, por që fitimi i cilësisë së ortakut nga ana e Ministrisë nuk ka qenë parashikuar kurrë në statut. Ortakët bien dakort për ndryshimet përkatëse të Statutit.

Pas përfundimit të diskutimeve, Asambleja, me unanimitet vendosi:

1. shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Administrativ të emëruar në proçesverbalin e asamblesë së datës 10.4.1995, dhe emërimin, në vend të tyre, e Z. Isuf Isufi si administrator të vetëm të Shoqërisë;
2. shkarkimin e ekspertëve kontabël të emëruar në proçesverbalin e asamblesë së datës 10.4.1995;
3. paraqitjen në statut të të gjitha ndryshimeve të nevojshme që përcaktojnë fitimin e cilësisë së ortakut nga ana e Ministrisë

Mbledhja është mbyllur pas marrjes së vendimeve të mësipërme.

Në këto kushte kur kërkesa për depozitimin e vendimit të datës 02.10.2001, të mbledhjes së Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të Shoqërisë "Almod" Sh.p.k., është e bazuar në kërkesat e ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe në dokumentat e kësaj Shoqërie, ajo duhet te pranohet.

## **PËR KËTO ARSYE:**


Në bazë të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", dhe Ligjit nr. 7667, datë 18.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Plotësuar nga Shoqëritë Tregtare",

### **VENDOSA:**

1. Pranimin e kërkesës së bërë nga ana e kërkuarit Znj. Klotilda Ferhati, në cilësinë e përfaqësueses ligjore të Shoqërisë "ALMOD" sh.p.k., në bazë të prokurës lëshuar nga administratori z. Isuf Isufi.
2. Depozitimim e vendimit datë 02.10.2001 të mbledhjes së Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të Shoqërisë "ALMOD" Sh.p.k., i cili pasqyron mosmiratimin e bilancit të vitit 2000, shkarkimin e Këshillit Administrativ dhe emërimin e Z. Isuf Isufi si administrator të Shoqërisë, shkarkimin e ekspertëve kontabël të emëruar, fitimin e cilësisë së ortakut në shoqëri të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, dhe tekstin unik të statutit pas ndryshimeve.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrin Tregtar që të bëjë ndryshimet në kollonën nr....., dhe nr. rendor .....të regjistrin tregtar të kësaj Gjykate, duke u ndarë këto shënime me vizë të kuqe nga njëri-tjetri.

Tiranë, më datë 14 / 12 / 2001.

Gjyqtare  
**MAJLINDA DOGGA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
NR. 3698 REP.  
NR. 874 KOL.



**PROÇESVERBAL I ASAMBLESË SË ZAKONSHME TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
ALMOD SH.P.K.**

Sot, më 25.6.2003, në orën 12.30, përpara meje M. Sadushi, Notere në Tiranë, anëtare e Dhomës së Noterëve të Tiranës

*janë paraqitur*

1. Zonja Valentina Pine, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 13.8.1955, nr. pasaporte 0915226, në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Ekonomisë (më poshtë, "Ministria"), ortak i cili zotëron një kuotë të barabartë me 81,83% të kapitalit themeltar të shoqërisë Almod Sh.p.k. (më poshtë, "Almod" ose "Shoqëria"), në bazë të autorizimit bashkëngjitur këtij proçesverbali (shtojca 1);
2. Av. Klotilda Ferhati, lindur në Tiranë, Shqipëri më 11.4.1979, nr. pasaporte 0245131, në cilësinë e përfaqësueses së Shoqërisë të së drejtës italiane Simod S.p.A., ortak i cili zotëron një kuotë të barabartë me 18,17% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, në bazë të prokurës së bashkëngjitur këtij proçesverbali (shtojca 2).

Gjithashtu është i pranishëm në cilësinë e të ftuarit edhe Av. Valerio Abbangara.

Merr përsipër drejtimin e Asamblesë Znj. Vali Pine, dhe cakton sekretare Av. Klotilda Ferhati. Kryetarja deklaron se Asamblea e zakonshme e Shoqërisë është mbledhur rregullisht për të diskutuar dhe vendosur për sa më poshtë vijon

*rendi i ditës*

1. Largimin nga detyra e administratorit të shoqërisë të Z. Isuf Isufi;
2. Emërimin e Z. Avni Golja në detyrën e Administratorit;
3. Të ndryshme.

*Pasi u konstatua*

Prania e ortakëve që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e Shoqërisë, Kryetarja

*deklaron*

Asamblenë e mbledhur në mënyrë të vlefshme dhe në gjendje për të vendosur mbi rendin e ditës.

\* \* \*

**1. Largimin nga detyra e administratorit të shoqërisë të Z. Isuf Isufi**

Kryetarja e Asamblesë në cilësinë e përfaqësuesit të ortakut shtetëror, Ministrisë së Ekonomisë, deklaron se administratori aktual Z. Isufi, duhet të shkarkohet nga kjo detyre për paafësi dhe moskryerje detyre. Ai nuk ka përmbushur asnjë nga detyrat që Asambleja e mbajtur më datë 2 tetor 2001 i ka caktuar atij, si: përgatitja e bilanceve që nga krijimi i shoqërisë deri më vitin 2000, rifillimi i prodhimit dhe aktivitetit të shoqërisë, përgatitja e shoqërisë për privatizim, nuk ka bërë asnjë raportim tek ortakët gjatë punës së tij si administrator, etj.. Përfaqësuesi i ortakut Simod s.pa. është dakort me mendimin e përfaqësuesit të ortakut shtetëror.

Prandaj, pas një diskutimi të plotë dhe të ezauruar, Asamblea me unanimitet

***vendosi***

*Të shkarkojë nga detyra e administratorit Z. Isuf Isufi;*

**2. Emërimin e Z. Avni Golja në detyrën e Administratorit**

Në lidhje me pikën 2), të rendit të ditës Kryetarja theksoi se Ministria e Ekonomisë, në cilësinë e ortakut të shoqërisë Almod i ka propozuar Asamblese Z. Golja për tu emëruar në detyrën e Administratorit.

Z. Golja me anë të një deklaratë me shkrim më datë 24.06.2003 e pranon këtë detyrë.

Pas një diskutimi të plotë dhe të ezauruar, Asamblea me unanimitet

***Vendosi***

1. Miratimin e Z. Avni Golja, lindur në Durrës, më 04.03.62, banues në Durrës, me pesh. n. 0389721, në cilësinë e administratorit të shoqërisë Almod sh.p.k.

2. Administratori i shoqërisë, Z. Avni Golja ngarkohet për të kryer procedurat përkatëse për të depozituar Vendimin e Asamblesë së Shoqërisë Almod sh.p.k. datë 25.6.2003, në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së parë, Tiranë.

\* \* \*

Me kërkesën e Av. Ferhati, Kryetarja e Asamblese i kalon fjalën av. Ferhati, e cila kërkon që të shtohen në verbal deklaratat e mëposhtme të bëra nga ortaku Simod s.p.a.:

10. F